



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimit Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 14.09.2024 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Activa Group” shpk nga Suhareka, bie këtë :

VENDIM

I

Aprovohet **si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “Activa Group” shpk nga Suhareka e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën **14.09.2024** për aktivitetin e prokurimit me numër: **626-24-8441-5-1-1** dhe nr. të brendshëm: **626-24-020-5-1-1** me titull: “**Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë**”

II

Korrigjohen kërkesat për dëshmi tek pika 5 dhe 6.2 e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të cilat do të ndryshohen me korrigjimin e procedurës. Ndërsa të gjitha kërkesat dhe dëshmitë tjera mbesin të njëjta.

III

Anulohet njoftimi për pezullim të procedurës së prokurimit i datës 16.09.2024 pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

IV

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Activa Group” shpk nga Suhareka me datë **14.09.2024** përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit në lidhje me njoftimin e kontratës dhe kriterëve të kërkuara për procedurën e prokurimit në fjalë nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “**Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë**”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-s. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë për procedurën në fjalë sa i përket mundësive teknike dhe profesionale për kualifikimin e operatorëve ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit në fjalë, janë të mbështetura në punët që janë paraparë në paramasë dhe parallogari si dhe në projektin ekzekutiv të bashkangjitur kësaj procedure të cilat duhet të kryhen nga kontraktuesi. Andaj tek këto kritere, nuk paraqitet asnjë kriter diskriminues ose favorizues si dhe nuk cenohet e drejta e asnjë O.E. që të ofertojë. Kriteret e përcaktuara, janë kritere minimale profesionale të natyrës së kontratës në mënyrë që përveç çmimit më të ulët të kemi edhe një operator ekonomik të përgjegjshëm, sepse ky projekt është i rëndësishëm së veçantë për komunën tonë. Në këtë procedurë kemi të bëjmë me një aktivitet të prokurimit me vlerë të madhe dhe nga çdo tenderues kërkohet të dëshmon që ka kapacitetin e duhur teknik dhe profesional me të cilat dëshmon dhe bind autoritetin kontraktues se mund ta ekzekuton dhe përfundon një projekt të tillë sipas afateve kohore.

Autoriteti Kontraktues me rastin e vendosjes së kërkesave për pjesëmarrje ka pasur kujdes të veçantë që kriteret duhet të përmbushin objektivin e natyrës së punimeve, duke u bazuar në legjislacionin e prokurimit në mënyrë që të mos ndikojnë në kufizimin e konkurrencës, por që të sigurojnë që kontraktimi dhe ofertimi i kompanive në këtë aktivitet të prokurimit të jetë i natyrës së projektit në fjalë.

Operatori ekonomik gjatë kërkesës për rishqyrtim në pretendimet e tij, thirret në diskriminim dhe kufizim të konkurrencës e në fakt këto pretendime nuk janë të bazuara apo të referuara në dispozita ligjore dhe në natyrën e kontratës, sepse nuk janë marrë për bazë punimet të cilat kanë për tu ekzekutuar në këtë kontratë për të ardhur në përfundimin që po diskriminohet ndonjë operator ekonomik apo po kufizohet konkurrenca. Përveç anës deklarative për më tepër këto pretendime të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe të ngritura nga ana e O.E. më tepër synojnë një përshkrim paushall që shumnica e kërkesave të AK të largohen si të pa nevojshme apo të përshtaten me dokumentet që i posedon O.E në fjalë.

Andaj ne në mënyrë që të rrisim konkurrencën e kompanive serioze në këtë aktivitet të prokurimit dhe të i japim hapësirë për mundësinë e ofertimit secilit O.E. të interesuar, ne kemi lejuar që tek stafi profesional dhe tek kërkesat teknike profesionale kompanitë të cilat nuk e kanë stafin e tyre të rregullt t'u mundësohet angazhimi i stafit me kohë të caktuar në bazë të marrëveshjes. Pastaj, duhet pasur parasysh se kemi kërkuar pothuajse vetëm nga një inxhinier të lëmive të ndryshme sipas punëve që kanë për tu realizuar. Pra është kërkuar staf minimal i kualifikuar pa të cilët nuk mund të garantohej mbarëvajtja e punimeve. Gjithashtu sipas legjislacionit të prokurimit dhe dosjes së tenderit, është paraparë që tenderi mund të dorëzohet në grup nga disa operator ekonomik me qëllim që t'i përmbushin kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues është cekur se: AK ne piken 2.1. dhe 2.2 kërkon që OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, 2.1 O.E. duhet të caktoj me deklaratë të qartë ose me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit, dhe 2.2 O.E. duhet të caktoj me vendim udhëheqësin e punishtes, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 10 (dhjet) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet ne punë, i certifikuar për rreziku në lartësi, i certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit.

AK tek menaxheri i punishtes, që ka përgjegjësinë kryesore të realizimit të kontratës kërkon përvojë 5 vjeçare pas diplomimit, ndërsa për udhëheqësin kërkon 10 vite përvojë. Kjo kërkesë është diskriminuuese, andaj kërkojmë që AK të rishqyrtojë këtë pozicion dhe për menaxherin e Punishtes të kërkojë 10 vite përvojë pune, ndërsa për udhëheqësin 5 vite përvojë pas diplomimit.

Sa i përket këtij pretendimi (2.1) operatori ekonomik ankues nuk ka paraqitur asnjë rrethanë faktike dhe bazike se pse qëndron pretendimi i tyre. Kërkesat në lidhje me këtë pikë janë vendosur në harmoni me rëndësinë e projektit. Me vetë faktin se natyra e projektit “Ndërtimi i qendrës kulturore” dhe duke analizuar rëndësinë e projektit, lartësinë e tij dhe kohën që do të realizohet ky projekt është mëse i domosdoshëm, që një inxhinier i tillë të jetë prezent me përvojën dhe certifikatat e kërkuara. Këto certifikata janë kërkuar pasi që menaxheri i projektit do të jetë në menaxhim të projektit dhe stafit duke garantuar mbarëvajtjen e punës sipas certifikimeve të kërkuara. Pretendimi në fjalë është i pa bazë.

Më tej O.E. thekson që AK për udhëheqësin e punimeve kërkon që i njëjti të jete i certifikuar për - siguri dhe shëndet në punë, - për rreziku në lartësi, - për mbrojtje nga zjarri dhe - specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit AK të njëjtat kërkesa i ka paraqitur edhe për menaxherin e punishtes, andaj dy inxhinierë me të njëjtat certifikime janë të panevojshëm. Kërkojmë nga AK që të rishqyrtojë këtë kërkesë, dhe të heq kërkesat nga njeri pozicion menaxher/udhëheqës i punishtes, dmth njeri nga këta të dy të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, i certifikuar për rreziku në lartësi, i certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit.

Sa i përket pretendimit për pikën 2.2 duhet të theksojmë që kërkesa që udhëheqësi i punishtes të ketë përvojë dhjetë (10) vite është vendosur sipas rëndësisë së projektit duke analizuar rëndësinë e sajë. Duke pasur parasysh që udhëheqësi i punishtes do të jetë vazhdimisht në objekt, është bërë një kërkesë e tillë duke shfrytëzuar përvojën e tij si dhe certifikimet e kërkuara që janë adekuate për këto lloj ndërtime duke garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në venin e punës. Pretendimi në fjalë është i pa bazë.

Në pretendimin tjetër O.E. për pikën 2.3 Një (1) inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Arkitekture, kërkohet të ketë min. 3 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Thekson se kërkojnë nga AK që të rishqyrtojë këtë pozicion pasi që kërkesat për siguri dhe shëndet në punë dhe për mbrojtje nga zjarri mbulohen nga personi përgjegjës për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri, dhe këto pune nuk janë përgjegjësi e Arkitektit, aq më tepër kur kemi të bëjmë për një projekt ekzekutimi/zbatimi e jo për një objekt që është në fazën e projektimit. AK në këtë rast diskriminon pjesëmarrjen e OE me Arkitekt me përvojë në ekzekutime të punimeve, duke e pamundësuar pjesëmarrjen në mungesë të certifikatave, edhe pse i njëjti ka përvojë shumëvjeçare në ekzekutimin e objekteve të ngjashme.

Sa i përket këtij pretendimi O.E. ankues nuk ka ofruar kurrfarë fakti apo referimi në dispozita ligjore se përse kërkesa në fjalë e kufizon pjesëmarrjen duke u bazuar se një O.E. të ketë person të certifikuar në bazë të ligjit për siguri dhe shëndet në punë. Pretendimi se arkitekti është vetëm në fazën e projektimit është i pa qëndrueshëm, pasi që arkitekti duhet të përcjellë realizimin e projektit në faza të ndryshme të përcaktuar në paramasë dhe projekt.

Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe karakterin e projektit, një kërkesë e tillë është e nevojshme pasi që një Arkitekt me përvojë minimale të punës prej tre (3) viteve me certifikimet e nevojshme për të realizuar këtë objekt të rëndësisë së veçantë, kërkohet në përshtatje me pozicionet e paramasës

konkretisht punët e suvatimit, lysterjes dhe fasadës së jashtme të përshkruar në pozicionet 6 dhe 7. Andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Më tej O.E ankues pretendon se 2.4 Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi Infrastrukturë rrugore), kërkohet të ketë min. 8 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar për menaxhimin e projekteve dhe të jete i pajisur me Certifikatë për siguri rrugore. AK kërkon nga OE te prezantoje një inxhinier te infrastrukturës rrugore, dhe i njëjti te ketë certifikate për siguri rrugore. Përkufizimi i AK ne këtë pike është diskriminues dhe i panevojshëm. AK me këtë rrezon kualifikimin e inxhinierit te infrastrukturës, duke kërkuar qe i njëjti edhe pse i kualifikuar për infrastrukture rrugore është jo kompetent, dhe duhet te këtë edhe një certifikate për siguri rrugore. AK ne këtë rast përmbledhë punën e një Inxhinieri te Infrastrukturës rrugore bashke me një Inxhinier te komunikacionit. Kërkojmë qe AK ne këtë pike, te rishqyrtoj pozicionin dhe te kërkoje një inxhinier te infrastrukturës rrugore dhe te shtoj kërkesën për një inxhinier te komunikacionit, për te plotësuar ne mënyre te kënaqshme nevojat për një pune kualitative.

Sa i përket këtij pretendimit duhet të theksojmë që kërkesat janë vendosur në harmoni me rëndësinë e projektit dhe duke e pa karakterin e objektit në fjalë është e nevojshme një kërkesë e tillë. O.E. mund të shikojë pozicionet e paramasës, konkretisht punët e oborrit pos. 1, 2, 3, 4 dhe 5 dhe të bindet që një kërkesë e tillë është e bazuar. Pra pretendimi është bërë pa paraqitur asnjë rrethanë faktike dhe bazike andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Në pretendimin për pikën 2.5 O.E. ankues thekson se: 2.5 Një (1) inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit dhe të ketë menaxhuar së paku një projekt dhe të ofroj dëshmi për një menaxhim të tillë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri i certifikuar me ISO 9001 2015- I certifikuar me ISO 500001 2018 si dhe të jetë Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ne këtë pike, AK diskriminon ne mënyre te skajshme pjesëmarrjen e OE ne këtë procedure. Inxhinieri Hidroteknik nuk ka asnjë përgjegjësi për eficiencën energjetike qe dëshmohet me certifikatën 50001, dhe inxhinieri hidroteknik nuk është përgjegjës për menaxhimin e kualitetit te përgjithshëm te punimeve, sepse kjo është përgjegjësi e menaxherit te punishtes, ose e një personi te kualifikuar te përcaktuar për QA/QC, I cili jo domosdoshmërisht duhet te jete inxhinier. Edhe me tepër AK e rëndon diskriminimin kur për te njëjtin pozicion kërkon qe te jete i certifikuar për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis. Vlerësimi i ndikimit ne mjedis është përgjegjësi e inxhinierit te mjedisit e jo një inxhinieri hidro, e aq me pak për një projekt te caktuar ku inxhinieri hidro kërkohet për punët hidroteknike. Kërkojmë nga AK qe këtë pikë ta shpërbeje, dhe kërkojmë një inxhinier hidroteknik me përvojë 5 vjeçare, 1 person te certifikuar si auditor për menaxhimin e kualitetit sipas ISO 9001-2015 Dhe 1 inxhinier mjedisi qe posedon edhe certifikatën për VNM.

Duke u bazuar në rëndësinë e objektit dhe kohën që do të realizohet është mase e nevojshme që një inxhinier me kualifikime dhe certifikime të kërkuara më lartë të jetë i kyçur në projekt. I sugjerojmë O.E. ankues që të shikon pozicionet e paramasës dhe projektit konkretisht pjesën e Hidroinstalimeve dhe Hidrantet sipas të cilave lind një kërkesë e tillë që O.E. të ketë një person të certifikuar me ISO 9001 2015, ISO 50001 2018 për sigurinë dhe shëndetin në punë sepse është shumë e rëndësishme për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në vendin e punës, vlerësimin në mjedis në vendin e punës e më gjerë në kohë afatgjate. Prandaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Më tej O.E. ka kërkuar sqarim në lidhje me pikën 2.11 në të cilën është kërkuar që O.E. pjesëmarrës të jenë 2.11 Një (1) Specialist për Sigurimin dhe Kontrollin e Mjedisit në Kantier. Me këtë rast thekson se kërkojnë nga AK që të sqarojë më në detaje se çfarë kualifikimi duhet të ketë Specialisti për kontrollin e mjedisit në kantier, dhe cili autoritet i akredituar në Kosovë mund të lëshojë këto certifikata. Gjithashtu ka kërkuar sqarim në lidhje me pikën 2.18 Një (1) person të certifikuar për sigurimin dhe kontrollin e mjedisit në kantier. Duke pretenduar se kjo kërkesë është diskriminuese dhe e dyfishuar vetëm për ngushtimin e mundësisë së pjesëmarrjes së OE në këtë procedure.

Sa i përket këtij pretendimi duhet të theksojmë se në kërkesën tonë nuk është kufizuar që punëtorët të jenë të certifikuar vetëm nga një autoritet i akredituar në Kosovë, por O.E. të interesuar mund të paraqesin këto certifikata të lëshuara nga institucionet që janë të akredituara në vendin tonë apo në një vend tjetër që ofron këto trajnime dhe lëshojnë certifikatat përkatëse.

Më tej O.E. thekson se AK në Kërkesa 5.-Certifikim kërkon që OE të jenë të pajisur me: 1. ISO 45001 2018-Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. 2. ISO 9001 2015-Sistemi i menaxhimit të Cilësisë 3. ISO 14001 2015-Sistemet e menaxhimit të Mjedisit. 4. ISO 39001 2012-Sistemet e menaxhimit të Sigurisë në trafikun Rrugor, 5. ISO 50001 2018 Certifikata për sistemin e menaxhimit të energjisë, 6. ISO 6892 2019 Sistemi i menaxhimit të materialeve metalike, 7. ISO 3834-2 2021 Sistemi i menaxhimit të cilësisë së saldimit të materialeve metalike. 8. ISO 28001 2007 Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit. AK kërkon që si Dëshmia për pikën 5- Certifikatat të jenë valide dhe të noterizuara nga origjinali para datës së njoftimit për kontratë. AK përmes kësaj kërkesë qëllimisht limiton pjesëmarrjen e OE, të cilët mund të kenë të gjitha këto certifikata, por që të njëjtat nuk i ka të noterizuara, Kjo kërkesë është tërësisht jologjore, pasi që kjo kërkesë shfuqizon vlefshmërinë e certifikatës origjinale dhe i jep plotfuqishmëri një certifikate të noterizuar nga origjinali. AK këtë kërkesë duhet ta rishqyrtoj dhe ta bejë "certifikatat të jenë të lëshuara para datës së njoftimit dhe të noterizuara pas datës së njoftimit për kontratë". AK duhet të rishqyrtojë këtë kërkesë, dhe të heq kërkesat për certifikata ISO në fazën e tenderimit, dhe të njëjtat ti kërkojë në fazën e implementimit të punëve, dhe jo vetëm si certifikata, por të kërkojë nga OE që do të shpërblehet me kontratë edhe zbatimin de-facto të këtyre standardeve konform kërkesave të Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve (ISO).

Sa i përket këtij pretendimi, duhet t'ia rikujtojmë O.E. ankues se ky projekt është i rëndësishëm së veçantë për komunën tonë andaj për të përzgjedhur një O.E. të përgjegjshëm dhe serioz në mënyrë që të realizohet ky projekt është paraprë si e domosdoshme që të aplikohen standardet e cekura më lartë e të cilat janë në përshtatje me legjislacionin e prokurimit.

Por mendojmë që O.E. ka të drejtë sa i përket dëshmisë që certifikatat të jenë të noterizuara para datës së shpalljes së njoftimit për kontratë. Por nuk pajtohemi që këto certifikata të noterizohen dhe të paraqiten pasi që të shpërblehet me kontratë O.E. pasi që do të ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse kërkesat duhet të përcaktohen para se të shpallet tenderi d. Sidoqoftë, kjo kërkesë konsiderohet pjesërisht e bazuar dhe ne do të bëjmë korrigjimin e procedurës në të cilën do të kërkojmë që si dëshmi të ofrohen kopjet e certifikatave valide të cilat duhet të jenë të noterizuara jo më larg se gjashtë (6) muaj nga data e shpalljes së tenderit dhe të njëjtat mund të noterizohen deri në kohën e fundit për dorëzimin e tenderit. Andaj konsiderojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Më tej O.E. ka paraqitur pretendimin se kërkesa 6.1 - OE duhet të ketë bazë për prodhimin e betonit në pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton dhe të dëshmojë se baza për prodhimin e betonit i ka certifikatat e përditësuara dhe kërkesa 6.2- OE duhet të ketë bazë për prodhimin e asfaltit në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt dhe të dëshmojë se baza për prodhimin e asfaltit i ka certifikatat e

përditësuar dhe të jetë i certifikuar me CE në bazë të licencës konform standardit EN 13108, dhe EN 12697 për prodhimin e asfaltit AB11, BZH22 AK kërkon certifikate në baze të standardeve EN 13108 dhe EN 12697. Më tej thekson se kërkojmë që AK ta rishqyrtoj këtë pozicion dhe të heq kërkesat për norma EN, pasi që asfalti nuk është për eksport. Dëshmia 6.2 - Kopja e Lejes për aktivitet të veçantë e lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, Edhe tek kërkesa "OE duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim e noterizuar si dhe certifikata për prodhim të asfaltit e noterizuar para njoftimit për kontratë" AK bën shkelje ligjore duke kërkuar plotësimin e kushtit akoma të pa kërkuar, andaj kjo kërkesë kërkojmë të rishqyrtohet dhe të hiqet në plotnin e saj.

Sa i përket këtyre kërkesave të njëjtat janë në harmoni me paramasën pasi që në shumicën pozicioneve është paraparë furnizimi me beton si dhe tek punët e oborrit në pozicionin nr. 4 është paraparë furnizimi dhe ndërtimi i oborrit me asfalt BZH11 dhe AB 11 andaj është e natyrshme që të kërkohej certifikatat për këto lloje të asfaltit. Ndërsa pajtohemi me O.E. në lidhje me dëshminë e kërkuar që OE duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim e noterizuar si dhe certifikata për prodhim të asfaltit e noterizuar para njoftimit për kontratë. Kjo kërkesë për dëshmi do të korrigjohet ku kërkesa do të jetë që O.E. të ofroj si dëshmi certifikatat e kërkuar ose marrëveshjen për furnizim të noterizuar jo më larg se gjashtë (6) muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Konsiderojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar pasi që ne si Autoritet Kontraktues me rastin e vendosjes së kriterëve dhe kërkesave për pjesëmarrje nuk kemi pasur kurrfarë qëllimi që të favorizojmë apo diskriminojmë operatorët ekonomik por jemi munduar që kërkesat të jenë në përshtatje me natyrën e projektit dhe me dispozita ligjore të legjislacionit të prokurimit.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 18.09.2024

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashetrojë ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues.